




Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority



Prishtinë, më 26.10.2023

MP. 97/23

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës në mbështetje të nenit 26, paragrafi 1.8 dhe 1.11, neni 32, paragrafi 3, neni 39, neni 55 paragrafi 2, nën paragrafi 2.5 të Ligjit Nr. 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, duke u bazuar në kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, të datës 19.05.2023, nëse ndërmarrja Visametric ka keqpërdorur pozitën dominuese në treg duke përcaktuar çmimin jo proporcional me çmimin e tregut për shërbimin postar prej 30 euro si dhe detyrimin e qytetarëve për të paguar këtë shërbim pa vullnetin e tyre, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës, në mbledhjen e datës 26.10.2023, jep këtë:

MENDIM PROFESIONAL

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës, veprimtarinë e vet e ushtron në bazë dhe për zbatim të Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, për të gjitha format e parandalimit, kufizimit ose shtrembërimit të konkurrencës nga ndërmarrjet në territorin e Republikës së Kosovës ose jashtë territorit, nëse veprimet e tyre kanë efekt në tregun e Republikës së Kosovës.

Autoriteti zbaton Ligjin Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës (LMK) në dy drejtime. Drejtimi i parë lidhet me veprimtarinë bazë të Autoritetit të Konkurrencës, veçanërisht me vendimmarrjen, ndërsa drejtimi i dytë ka të bëjë me avokimin e konkurrencës, përmes mendimeve, rekomandimeve, kumtesave, të cilat e rrisin vetëdijen për kulturën e konkurrencës në treg, duke përfshirë legjislacionin, politikat, zhvillimet krahasuese, përmes bashkëpunimit, me organe dhe institucionet publike.

Bazuar në nenin 2 fushëveprimi i Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, vlenë edhe për ndërmarrjet të cilave në bazë të rregulloreve të veçanta, u është besuar kryerja e shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik, ndërmarrjeve që për nga natyra e tyre janë monopol dhe që ju krijojnë të ardhura atyre, në bazë të drejtave të veçanta ose ekskluzive të caktuara, u është besuar kryerja e një veprimtarie të caktuar dhe atë vetëm në rastet kur zbatimi i LMK-së nuk do të pengonte, ligjërisht dhe faktikisht, kryerjen e detyrave që u përcaktohen me rregullore dhe masa të veçanta dhe për të cilat janë krijuar.

Në këtë rast Visametric, Ministria e Punëve të Jashtme të Gjermanisë ka vepruar si autoritet kontraktues, pas përmbylljes së një procedure rajonale të prokurimit për Evropë të zhvilluar në Berlin, me c' rast, ka përzgjedhur ndërmarrjen Visametric, e cila ka fituar "kontratën për ofrim të shërbimeve për zhvendosjen e pranimi të aplikacioneve për viza", duke e përfshirë edhe Republikën e Kosovës.

Kontrata ndërmjet MPJ të Gjermanisë dhe ndërmarrjes Visametric, buron në bazë të marrëveshjes të lidhur me Ministrinë e Jashtme Federale, mbi prokurimin publik në bazë të rregulloreve që e rregullojnë procedurën e prokurimit. Ambasada gjermane në Prishtinë nuk ka pasur dhe nuk ka ndikim në përzgjedhjen e kontraktuesit.

Bazuar në vërtetimin e datës 16.08.2023 të lëshuar nga Ambasada Gjermane në Kosovë dhe informacioneve të siguruar nga ueb faqja e Ambasadës Gjermane, Autoriteti i Konkurrencës vlerëson se autoriteti kontraktues (MPJ Gjermane) ka përcaktuar kushtet e subjektit të tenderit, bazuar në rregullore të veçanta që rregullojnë një zonë të caktuar. Këto kushte ndërlidhen veçanërisht për kryerjen e aktiviteteve dhe/ose ofrimin e shërbimeve për të cilat është e nevojshme të plotësohen kushte të veçanta, shtesë që lidhen, si në rastin konkret, me "kontratën për ofrim të shërbimeve për zhvendosjen e pranimi të aplikacioneve për viza".

Për më tepër, Autoriteti i Konkurrencës, nuk është kompetent për të vlerësuar procedurat e prokurimit publik në rastin konkret dhe sjelljen e autoritetit kontraktues, në këtë kuptim.

Ndërmarrja Visametric është partner/ kontraktues zyrtar i Ambasadës Gjermane Prishtinë që nga data 13.09.2022. Tarifat të cilat i kërkon Visametric për shërbimet e saja, sipas dëshmimeve të ofruara në dispozicion, janë koordinuar dhe miratuar me Ministrinë e Jashtme Federale të Gjermanisë.

Ambasada në koordinim me seksionin përkatës në Ministrinë e Jashtme Federale të Gjermanisë ka qenë e informuar që Visametric do të bëjë dorëzimin e pasaportave të udhëtimit përmes shërbimit të dërgesave me kurier Speed Kargo. Ministria dhe Ambasada, sipas dëshmimeve të ofruara në dispozicion nga Visametric, i kanë ditur shpenzimet për dërgimin e pasaportave, dhe njëherë Ambasada dhe seksioni përkatës në interes të një sistemi optimal eficient të përpunimit të kërkesave për viza, kanë sugjeruar ta bëjnë të obligueshme dërgimin e pasaportave përmes dërgesave korrier, pasi njëjtë vepron edhe vetë Ambasada. Pëlqimin lidhur me dërgimin e detyrueshëm të pasaportave të udhëtimit Visametric, sipas shkresave të lëndës, e ka marrë të konfirmuar me shkrim nga Ministria e Jashtme Federale e Gjermanisë.

Bazuar në nenin 8 të Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, lidhur me Përcaktimin e pozitës dominuese, Autoriteti i Konkurrencës konstaton që Visametric posedon pozitë dominuese për shërbimet e caktuara, të fituara ekskluzivisht nga Ministria e Punëve e Jashtme të Gjermanisë përmes procedurave të tyre të përzgjedhjes së operatorit për kryerjen e shërbimeve të tyre në vendin tonë.

Në bazë të shkresave dhe dëshmimeve të ofruara nga Prokuroria, përmes një videoje, rreth aplikimit për termin përmes Visametric, dhe ankesave të konsumatorëve, konsiderojmë që ka elemente që na çojnë në keqpërdorimin e pozitës dominuese, mirëpo në bazë të shkresave, rrethanave dhe dëshmimeve që posedojmë nuk mund të konstatojmë me saktësi një gjë të tillë.

Duke u bazuar në nenin 9 paragrafi 2 nën paragrafët 2.1 dhe 2.2, të Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës ndërmarrja keqpërdor pozitën dominuese kur një ndërmarrja drejtpërdrejt ose tërthorazi vendos çmim të padrejtë të blerjes ose shitjes ose kushte tjera të padrejta tregtare si dhe: kufizon prodhimin, tregjet ose zhvillimin teknologjik në dëm të konsumatorëve. Autoriteti vlerëson se ndërmarrja Visametric, nuk ka vendosur në mënyrë të pavarura çmimin dhe kufizimet, por në rastin konkret, nga Ministria e Punëve e Jashtme Federale e Gjermanisë ka përcaktuar çmimin dhe operimin e ndërmarrjes Visametric.

Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës konsideron se në bazë të provave të ofruara, në këtë rast, kemi të bëjmë po ashtu me praktika të padrejta tregtare, e të cilat duhet trajtuar në kuptim të Ligjit nr. 06/L-034 për Mbrojtjen e Konsumatorit. Gjithashtu, meqenëse objekt shqyrtimi janë dërgesat postare, ky rast mendojmë se duhet trajtuar edhe nga Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare pasi ofrimi i shërbimeve postare është treg i rregulluar.


Autoritetit i Konkurrencës në bazë të detyrave dhe përgjegjësisë të saj rezervon të drejtën që në të ardhmen në varësi të rrethanave dhe provave të reja, të inicioj procedure hetimore ndaj ndërmarrjes Visametric.

AUTORITETI I KONKURRENCËS
Komisioni

Neime Binaku - Isufi
Kryetare




Kaltrina Sela
Nënkryetare




Florent Mehmeti
Anëtar



Nafije Osdautaj
Anëtar



Salihe Gashi Loku
Anëtar



Me këtë Mendim Profesional të njoftohet:

- Prokuroria Themelore në Prishtinë
- Arkiva